



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:150111

Datë: 15.01.2025

Numri i dokumentit: 06710824

PAKR.nr.666/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku, kryetar i kolegjit, Kadrije Goga Lubishtani dhe Valbona M Selimaj, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Jeta Asllani, në çështjen penale kundër të akuzuarve SH.R dhe R. R për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 173 par.1, pika 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe secili veç e veç për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, për të akuzuarin R. R vepra penale Vrasje e rëndë nga neni 173 par.1, pika 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, është rikualifikuar në veprën penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 173 par.1, pika 1.5 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, dhe i akuzuari F. M për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit SH.R , Av. Mahmut Halimi, ankesës se mbrojtësit të të akuzuarit R. R , Av. Shyqyri Syla dhe ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit F. M , Av. Gani Rexha, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.118/23, të datës 10.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit SH.R , Av. Mahmut Halimi, ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit R. R , Av. Shyqyri Syla dhe ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit F. M , Av. Gani Rexha, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës

Themelore në Mitrovicë, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.118/23, i datës 10.09.2024, Vërtetohet.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë, Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin, PKR.nr.118/23, të datës 10.09.2024, të akuzuarin SH.R e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 173 par.1, pika 1.5 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar: Për veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 pika 1.5 të KPRK-së, dënim me burgim ne kohëzgjatje prej njëzet e dy (22) vjet.Për veprën penale Mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dënim me burgim ne kohëzgjatje një (1) vjet e gjashtë (6) muaj.

Në aplikim të dispozitës ligjore nga neni 76 par.1 dhe 2 pika 2.2 të KPRK-së, të akuzuarit SH.R i ka shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej njëzet e tri (23) vjet, i cili dënim do te ekzekutohet pasi qe aktgjykimi të bëhet i formës se prerë.

Të akuzuarit SH.R i është vazhduar masa e paraburgimit derisa aktgjykimi të merr formën e prerë por jo më shume se dënimi i shqiptuar.

Të akuzuarit SH.R koha e kaluar ne masën e paraburgimit prej datë 27.07.2022, e tutje i është llogaritur në dënimin e shqiptuar unik me burgim.

Nga i akuzuari SH.R në mënyrë të përhershme është konfiskuar arma e zjarrit-pushka automatike AK-47 me nr. serik ..., e njëjta pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë do të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, nëse nuk është e evidentuar ne librin e rasteve të hapura.

Të akuzuarin R. R e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 pika 1.5 lidhur me nenin 33 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim me burgim ne kohëzgjatje prej trembëdhjetë (13) vjet. Ndërsa e ka liruar nga akuza për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Të akuzuarit R. R i është vazhduar masa e paraburgimit derisa aktgjykimi të merr formën e prerë por jo më shumë se dënimi i shqiptuar.Të akuzuarit R. R koha e kaluar ne masën e paraburgimit prej datë 23.07.2022, e tutje i është llogaritur në dënimin e shqiptuar.

Të akuzuarin F. M e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim

të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së. Për veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, i është shqiptuar dënim me burgim ne kohëzgjatje prej tri (3) vjet.Për veprën penale Mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i është shqiptuar dënim me burgim ne kohëzgjatje prej një (1) vjet.Në aplikim të dispozitës ligjore nga neni 76 par.1 dhe 2, pika 2.2 të KPRK-së, të pandehurit F. M i është shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej tri (3) vjet e gjashtë (6) muaj, i cili dënim do te ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës se prerë.

I akuzuari SH.R është obliguar që në emër te shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej dyqind (200) euro, në emër të paushallit gjyqësor shumën në lartësi prej pesëdhjetë (50) euro dhe në emër të Fondit për Kompensimin e viktimave te krimit shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, të cilat është i obliguar qe t'i paguajë në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.I akuzuari R. R është obliguar që në emër te shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej dyqind (200) euro, në emër të paushallit gjyqësor shumën në lartësi prej pesëdhjetë (50) euro dhe në emër të Fondit për Kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, të cilat është i obliguar që t'i paguajë në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.I akuzuari F. M është obliguar që në emër te shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej treqind (300) euro, në emër të paushallit gjyqësor shumën në lartësi prej pesëdhjetë (50) euro dhe në emër të Fondit për Kompensimin e viktimave te krimit shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, të cilat është i obliguar qe t'i paguajë në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Përfaqësuesi ligjor i të ndjerit B. M , përkatësisht vëllai i tij B. M dhe i dëmtuari L. A për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest civil.

Po ashtu edhe SH.R , si i dëmtuar në raport me veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, të kryer nga i akuzuari F. M , për realizimin e kërkesës pasurore juridike pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe për shkak të vendimit mbi dënimin. Gjykatës së Apelit i ka propozuar që të ndryshojë aktgjykimin sa i përket vendimit mbi dënimin dhe të akuzuarve t'iu shqiptojë një dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje më të lartë, ndërsa sa i përket vendimit mbi lirimin për

të pandehurin R. R , e po ashtu edhe sa i përket veprës penale dhe rikualifikimit nga vepra penale Vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par.1, pika 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së të njëjtin të kthejë në rigjykim dhe rivendosije.

Mbrojtësi i të akuzuarit SH.R , Av. Mahmut Halimi për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me dënimin. Gjykatës së Apelit i ka propozuar që të ndryshojë aktgjykimin e ankimuar, ashtu që të akuzuarin ta lirojë nga akuza për veprën penale në dispozitivin I në bazë të nenit 363 par.1, pika 1 lidhur me nenin 12 par.1 të KPRK-së, ndërsa për veprën penale në dispozitivin II t'i shqiptojë një dënim më të butë ose aktgjykimin ta prish dhe lëndën të kthejë në rigjykim. Ndërsa të hedhet si jo lëndore ankesa e Prokurorisë e ushtruar në raport me të akuzuarin SH.R , për bazën juridike të vendimit lidhur me dënimin.

Mbrojtësi i të akuzuarit R. R , Av. Shyqyri Sylja për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me dënimin. Gjykatës së Apelit i ka propozuar që të anulojë aktgjykimin e ankimuar dhe çështjen të kthejë në rigjykim dhe rivendosije, ose të ndryshojë aktgjykimin ashtu që të lirojë nga akuza për shkak se nuk është provuar kryerja e kësaj vepre penale, ose nëse Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt kur ka konstatuar një gjendje të tillë faktike atëherë aktgjykimin ta ndryshojë në aspektin e sanksionit penal ashtu që të pandehurit t'i shqiptojë një dënim më të butë me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit F. M , për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin. Gjykatës së Apelit i ka propozuar që të aprovojë ankesën, të anulojë aktgjykimin e ankimuar dhe çështjen të kthejë në rigjykimin ose të ndryshojë aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën penale Vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore nga neni 174 të KPRK-së dhe që të akuzuarit t'i shqiptojë një dënim me të butë me të cilin do të arrihet qëllimi i plotë i dënimit.

Prokuroria e Apelit me parashtresën PPA/I.nr.605/2024, të datës 14.11.2024 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe të ndryshojë aktgjykimin sa i përket vendimit mbi dënimin dhe të akuzuarve t'iu shqiptojë një dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje më të lartë, ndërsa sa i përket vendimit mbi lirimin për të pandehurin R. R , e po

ashtu edhe sa i përket veprës penale dhe rikualifikimit nga vepra penale Vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par.1, pika 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, aktgjykimi të anulohet dhe të njëjtën të kthejë në rigjykim dhe rivendosje. Ndërsa ka propozuar që të refuzohen si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve SH.R , Av. Mahmut Halimi, R. R , Av. Shyqyri Syla dhe F. M , Av. Gani Rexha

Në kuptim të nenit 390 të KPPRK-së, Kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për datë 12.12.2024 dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit B. M , Av. Amir Bunjaku, i dëmtuari L. A , i akuzuari SH.R , mbrojtësi i të akuzuarit SH.R , Av. Mahmut Halimi, i akuzuari R. R , mbrojtësi i të akuzuarit R. R , Av. Shyqyri Syla, i akuzuari F. M , ndërsa Prokurori i Apelit, përfaqësuesi ligjor i të ndjerit B. M , B. M , dhe mbrojtësi i të akuzuarit F. M , Av. Gani Rexha ndonëse të njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt nuk prezantuan në seancë. I akuzuari F. M në seancë ka deklaruar se pajtohet që të vazhdojë seancën pa prezencën e mbrojtësit.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit B. M , Av. Amir Bunjaku në seancë të kolegjit ka deklaruar se i bashkangjitet ankesës së prokurorit dhe kërkon që të ashpërsohet dënimi. Ndërsa sa i përket kualifikimit të veprës për të akuzuarin R. R , konsideron se është në kundërshtim me ligjin pasi konsideron që vepra është në bashkëkryerje. Gjithashtu ka deklaruar se parashtrojnë kërkesë pasurore juridike.

I dëmtuari L. A ka deklaruar, se i bashkangjitet ndjekjes penale dhe parashton kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësi i të akuzuarit SH.R , Av. Mahmut Halimi ka deklaruar, se mbetet në tërësi pranë pretendimeve ankimore. Ka shtuar se në ankesë është bërë një lëshim i natyrës teknike tek propozimet, pas pjesës që ka të bëjë nga akuza për veprën penale në pikën I duhet të shtohet në bazë të nenit 363 par.1, pika 1 lidhur me nenin 12 par.1 të KPRK-së. Ndërsa ka propozuar që të refuzohet ankesa e Prokurorit si e pabazuar ose të shpallet jolëndore nëse çështja kthehet në rigjykim.

I akuzuari SH.R ka deklaruar se e përkrah deklarinimin e mbrojtësit.

Mbrojtësi i të akuzuarit R. R , Av. Shyqyri Sylja ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë ankesës dhe propozimit në ankesë. Ndërsa ka propozuar që ankesa e prokurorit të refuzohet si e pabazuar.

I akuzuari R. R ka deklaruar, se e përkrah deklarinimin e mbrojtësit.

I akuzuari F. M ka deklaruar, se mbështet ankesën e mbrojtësit dhe mbetet në tërësi pranë asaj ankese.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPRK-së, i shqyrtoi shkresat e lëndës aktgjykimin e ankimuar dhe pasi vlerësoi pretendimet ankimore në ankesë gjeti se:

Ankesat e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe mbrojtësve të të akuzuarve SH.R , Av. Mahmut Halimi, R. R , Av. Shyqyri Sylja dhe F. M , Av. Gani Rexha, janë të pabazuara.

Pretendimet ankimore të Prokurorit të shtetit

Prokurori i shtetit në ankesë pretendon, se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale ngase nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 par.7 të KPPK-së, me të cilën gjykata është dashtë të paraqes qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara, e po ashtu është e obliguar që në bazë të ligjit të vlerësoj saktësinë e provave kundërthënëse dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështje penale për të cilën ka marrë aktgjykim lirues, e që në tërësi i mungojnë aktgjykimit të atakuar. Gjykata në arsyetimin e saj nuk ka përmend provat që janë proceduar gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke përkrahur taksativisht dhe nuk ka përmend krahasimin e dëshmimeve se a i beson apo jo asaj prove, arsyet me rastin e vlerësimit të provës.

Po ashtu, prokurori i shtetit pretendon se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike kur të akuzuarin R. R e ka liruar nga akuza për shkak të veprës penale Mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPPK-së, për arsye se i akuzuari armën dhe atë pushkën automatike A47 me numër serik ... e ka mbajtur në posedim në shtëpinë e përbashkët familjare e po ashtu edhe në ditën kritike i pandehuri këtë armë e ka poseduar në automjetin e tij ku me këtë armë është kryer edhe vepra penale. I pandehuri SH.R gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se armën e ka mbajtur në odë e që sipas traditës oda është e përbashkët ku anëtarët e familjes qëndrojnë së bashku e që i

pandehuri, e që i pandehuri e ka ditur se arma është pa leje përkatëse dhe e ka poseduar si pronësi e përbashkët familjare pasi që të pandehurit jetonin në një shtëpi. Gjithashtu ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ku për të pandehurin R. R ka rikualifikuar veprën penale nga Vrasje e rëndë në bashkryerje nga neni 173 parag. 1 pika 1.5 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në veprën penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 173 par 1, pika 1.5 lidhur me nenin 33 të KPRK-së pasi që i pandehuri veprën penale e ka kryer sipas kualifikimit si në aktakuzë e që kjo vërtetohet edhe si në aktakuzë se dy të pandehurit SH dhe R. R se në bashkëkryerje e kanë kryer veprën penale, e që vërtetohet edhe nga vet deklarata e të pandehurit R. R i cili ka deklaruar se kur është kthyer djali i tij F. R me automjet, prezent ka qenë edhe i pandehuri SH.R , ku F. ka qenë shumë i shqetësuar i dridhte dhe i ka thënë të pandehurit R se “ja kish mshu me guxhum në kerr A ”, dhe menjëherë pas kësaj të pandehurit Sh dhe R. R janë nise me automjet në drejtim të tyre, ku në automjetin e të pandehurit R. R t, kishin marrë me vete edhe armën automatike duke e poseduar pa leje përkatëse, ku me të cilën armë është kryer edhe vepra penale.

Gjendja faktike vërtetohet nga deklaratat e të dëmtuarve në këtë çështje penale, si dhe nga provat materiale që janë siguruar gjatë fazës së hetimeve, e që rezulton që të pandehurit veprën penale si në pikën I të dispozitivit e kanë kryer me dashje direkte dhe qëllim për të privuar nga jeta anëtarët e familjes M duke mos përjashtuar as personat e tjerë. Se i pandehuri SH.R ka shtënë disa herë në drejtim të tani të ndjerit B. M , L. A dhe personave tjerë, vërtetohet nga raporti i autopsisë, nga raporti i AKF-së, nga deklarata e të dëmtuarit L. A , nga deklarata e dëshmitarit A. F të cilët konfirmojnë faktin se ditën kritike i pandehuri Sh ka shtënë në drejtim të tyre, ndërkaq në këtë çështje penale kontribut thelbësor, e që është kriter për ekzistimin e bashkëkryerjes ka dhënë edhe i pandehuri tjetër R. R , i cili përveç se me paramendim dhe me qëllim të privimit nga jeta të anëtarëve të familjes M ka drejtuar veturën e tipit Audi deri në vendin e kryerjes së veprës penale, po ashtu vërtetohet fakti se ditën kritike është kacafytur me të pandehurin A. M , fakt ky i vërtetuar nga të gjithë dëshmitarët duke mos përjashtuar dhënien e kontributit kryesor në kryerjen e veprës penale. Që të dy të pandehurit me paramendim janë nisur të përgatitur me armën, të cilën e kanë futur në veturë dhe e njëjta është përdorur ditën kritike.

Gjithashtu sipas prokurorit, gjykata e shkallës së parë ka bërë edhe shkeljen e ligjit penal kur të pandehurin R. R e ka liruar nga akuza për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, ngase të gjitha provat vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Lidhur me vendimin mbi dënimin, prokurori i shtetit pretendon se dënimi i shqiptuar të pandehurve nuk është në proporcion me rrethanat të cilat i ka përmend gjykata sepse po të bazohej në këto rrethana rënduese gjykata të pandehurve do t'ju shqiptonte një dënim më të lartë me burg efektiv, pasi që të pandehurit SH.R dhe R.R veprat penale i kanë kryer me dashje direkte, duke privuar nga jeta të ndjerin B. M , që jeta e njeriut është gjëja më e shenjtë dhe vlerë e mbrojtur ndërsa edhe lëndimet trupore i ka shkaktuar të dëmtuarit L. A ndërsa i pandehuri F. M ka kryer veprën penale Vrasje në tentativë dhe veprën penale Mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së gjë që një dënim kaq i butë nuk është në proporcion me natyrën e kryerjes së veprave penale nga të pandehurit.

Pretendimet ankimore te mbrojtësit të të akuzuarit SH.R , Av. Mahmut Halimi

Lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale mbrojtësi pretendon se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nënpar.1.10 dhe par.2, nënpar.2.2 dhe 2.7 të KPPRK-së, për arsyet se: aktgjykimit i mungon plotësisht arsyetimi, prova qëndrore e kësaj çështjeje siç është ekspertiza balistike dhe mendimet e plotësimet e tyre si dhe deklarata e ekspertës së kësaj fushe H. H e dhënë në shqyrtimet gjyqësore, si dhe materialet audio video të kryera në rikonstruimin e vendit të ngjarjes nuk janë vlerësuar fare siç nuk është vlerësuar as përmbajtja e ekspertizës së krismave të nxjerra nga videoincizimet e kamerave të sigurisë nga shtëpia e K. S , ndërsa në veçanti nuk është bërë krahasimi i këtyre provave me provat tjera siç janë dëshmitë e dëshmitarëve L. Xh , L. A , Q M , siç nuk janë analizuar skicat e vizatuara nga këta dëshmitarë lidhur me pozitat e tyre në raport me të akuzuarit dhe provat tjera si dhe deklarata e të pandehurit F. M të cilat janë në tërësi kundërthënëse me provën e cekur.

Po ashtu, aktgjykimi është i përfshirë në shkelje nga par.2 nënpar.2.1, 2.5 dhe 2.7 të nenit 384 të KPPRK-së, ngase gjykata ka zbatuar gabimisht dispozitën e nenit 119.par.5 lidhur me nenin 123 par. 1 nënpar.1.3 të KPPR-së në raport me refuzimin e propozimit për dëgjimin e A. M në cilësi të dëshmitarit, ndërsa ka marrë si provë deklaratën e të akuzuarit R. R , në rrethanën se i akuzuari Sh paska qenë i njoftuar me ngjarjen kur A. M e ka detyruar të kthehet në shtëpi të birin e vëllait, duke mos e lejuar të shkonte në marketin e fshatit për të marrë pije për nevoja të dasmës e të cilën rrethanë i akuzuari Sh e ka mohuar në mënyrë kategorike. Ndërsa se aktgjykimi nuk

është përpiluar në pajtim me nenin 369 të KPPR-së, rezulton nga arsyetimi i aktgjykimit. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë së cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara, pastaj në mënyrën më të rëndë ka shkelur detyrimin e vlerësimit të saktësisë së provave tejet kundërthënëse të cilat kanë patur për pasojë vërtetimin e ekzistimit të veprës penale si dhe zbatimit të dispozitave ligjore ndaj të akuzuarit SH.R dhe veprës së tij.

Sipas mbrojtjes, gjendja faktike në këtë çështje është vërtetuar në mënyrë tejet të gabuar dhe jo të plotë, sepse pa kurrfarë mbështetje dhe në kundërshtim me të gjitha provat materiale iu është falur B dëshmitarëve L. Xh , Q M , të dëmtuarit L. A dhe dëshmisë së lexuar të dëshmitarit A. F . Në pasuesin e 3-të, të faqes 34 të arsyetimit në mënyrë të gabuar konstatohet se nuk ka qenë kontestues fakti se pasi në vendin e ngjarjes kanë arritur i pandehuri R. R i cili e ka ndalë automjetin, ndërsa SH.R me armë në dorë ka zbritur dhe përnjëherë ka shtënë me të njëjtën në drejtim të anëtarëve të familjes M , me c'rast ka goditur viktimën B. M dhe të dëmtuarin L. A . Kjo për arsyen se përveç deklaratës së të akuzuarit SH.R , edhe provat materiale e ekspertizat e vërtetojnë të kundërtën e konstatimit të tillë, pra se i akuzuari SH.R nuk ka shtënë me armë nga pozita posa ka dalë nga vetura, sepse gjurmët e gjetura në vendin e ngjarjes të përshkruara më afër në skicë dhe listën e matjeve të gjurmëve e në veçanti gjatë rikonstruimit të vendit të ngjarjes janë kontradiktore pasi rezulton mëse e sigurtë dhe e vërtetuar përtej çdo mëdyshje se pozita e të akuzuarit Sh në raport me viktimën, tani të ndjerin B. dhe të dëmtuarin L ka qenë më poshtë se këta dhe se vendndodhja e gëzhgojave të hedhura me rastin e zbrazjes nga arma automatike e të akuzuarit Sh , ndodhen në sipërfaqen e rrugës së asfaltuar. Pra i akuzuari Sh ka shtënë nga kanali mes murit të shtëpisë dhe rrugës si vend i vetëm i pozitës më poshtë se sipërfaqja e rrugës, për çfarë edhe trajektorja e predhës në trupin e tani të ndjerit B. është nga poshtë lartë dhe të dëmtuarit L në nivelin e njëjtë të mbi gjurit të të dy këmbëve. Dëshmia e dëshmitarit L. Xh se “Kam parë F. M n, i cili pasi është vlarë B , ka hyrë në oborr e ka marrë një llovackë gjuetie në shtëpinë e tij, dhe ka shtënë me qatë pushkë gjuetie njëherë në drejtim të personit i cili kishte automatin në dorë” , është në kundërshtim të plotë me deklarinimin e të pandehurit F i cili në zyrën e prokurorit ka theksuar se ai ka shkuar për ta marrë pushkën e gjuetisë në momentin kur axha i tij tani i ndjeri B. i ka thënë ”shko merre armën se shkuam posht... ".Nga ky krahasim i tillë rezulton se i akuzuari F para se të ndodhin të shtënat nga i akuzuari Sh , e ka patur të njëjtën edhe pse nga deklarata e të akuzuarit Sh rezulton se në fakt në momentin e ndalimit në rrugë posa është ndalur vetura, dhe babai i të akuzuarit F , A. M është afruar e ka tërhequr jashtë veturës të akuzuarin R duke e shtyrë atë në drejtim të dyerve të oborrit të tyre, ka parë të

akuzuarin F i cili në ato çaste ka patur pushkën e gjuetisë, me ç'rast ja ka drejtuar të akuzuarit R në pjesën e shpinës, ndërsa nuk është kontestues fakti se pas përfundimit të ngjarjes të akuzuarit Sh dhe R janë larguar në drejtim të shtëpisë së tyre. Po ashtu deklaratat e dëshmitarëve që i përkasin familjes M , së bashku me të dëmtuarin L. A e dëshmitarin A. F , janë në kundërtënie ekstreme dhe kanë mospërputhje diametrale me provat materiale siç janë procesverbalit i vendshiqimit, skica e vendit të ngjarjes me tabelën e matjeve të gjurmëve të gjetura.

Po ashtu, deklaratës së të miturit F. R dhe dëshmitarit H. B , gjykata e shkallës së parë nuk ua ka falur B n përkundër faktit se dëshmitari i mitur F. R kishte deklaruar në mënyrë tejet të sinqertë faktet se si është kthyer nga rruga pas veprimeve të A. M, se babi i tij i akuzuari R e kishte qortuar të njëjtin dhe se në ato momente axha i tij Sh u nuk ka qenë fare prezent. Po ashtu dëshmitari H. B që është djali i motrës së të akuzuarve Sh dhe R ka shprehur një shkallë të lartë të sinqeritetit dhe shpjegimit të rrjedhave të ngjarjes, ku përmes dëshmisë së tij është përforcuar fakti i pakontestueshëm se ditën kritike në shtëpinë e të akuzuarve Sh dhe R ka pasur dasëm pasi që ditën e nesërme motra e tyre do të martohej. Në kanagjeqin e motrës së tyre ka pasur shumë të ftuar dhe se të akuzuarit kanë qenë tejet të zënë me organizimin dhe pritjen e mysafirëve. Në këtë dasëm ai i ka dërguar nënën, bashkëshorten e vet dhe bashkëshorten e axhës dhe me të arritur kishte takuar dy dajtë e tij të cilët ishin duke pritur mysafirët, pasi janë përshëndetur dhe e kanë pasur një bisedë të shkurtër e kanë njoftuar se duhet të shkojnë në marketin e fshatit për të marrë pijet e porositura më herët për nevojat e dasmës. Ky dëshmitar këtë takim me të akuzuarit e përshkruan tejet normal, nuk kishte vërejtur ndonjë shqetësim emocional ose shqetësim në anën e tyre dhe pasi këta ishin nisur në market dhe dëshmitari pas 3 min ishte nisur për të shkuar në Prishtinë. Pasi që rruga që shpie në drejtim të daljes së fshatit kalon afër dyerve të oborrit të shtëpive të familjes M , fillimisht e kishte vërejtur të ndalur veturën e dajëve të tij për çka rreth 3 m pas saj kishte ndalur veturën dhe me të dal kishte vërejtur një tollovinë të cilën kishte parë se A. M e mbante të kapur të akuzuarin R të cilin mundohej ta fuste brenda dyerve të oborrit, se i akuzuari R ishte duke rezistuar dhe mbante dorën e majtë në shtyllën e derës, ky dëshmitar kishte parë edhe të akuzuarin F më pushkë në dorë, ndërsa duke u afruar kishte parë të akuzuarin Sh të rrëzuar në pjesën e kanalit i cili ndodhet mes murit të oborrit të familjes M dhe rrugës së asfaltuar, në ato çaste po ashtu e kishte vërejtur kur është ngritur i akuzuari Sh të cilin ka bërë përpjekje ta qetësonte pasi këtij i kishte vërejtur se mbante një pushkë automatike në dorë, gjithashtu duke u frikësuar nga rreziku që paraqiste i akuzuari F me armën e drejtuar nga i akuzuari Sh, ky kishte dal si mburojë e të akuzuarit Sh, në çastin kur kishte

dëgjuar dikënd se po vijnë policia, ato veprime janë ndalur ku pas pak i akuzuari F duke ia drejtuar këtij armën kërkon që të vendosin viktimën- të ndjerin B. në veturën e tij, ashtu që së bashku e fusin në veturë dhe nisën për në spitalin e Skenderajt së bashku me të akuzuarin F , ndërsa rrugës kishte ftuar përmes telefonit në numrin e spitalit me kërkesë që të përgatiten pasi është duke e sjellë një person të plagosur. Edhe i akuzuari F gjatë shpjegimeve të dhëna me rastin e këqyrjes dhe rikonstruimit të vendit të ngjarjes ka potencuar se ka vërejtur babain e tij A. M duke e shtyrë të dera e oborrit të akuzuarin R.

Gjithashtu, sikur të ndodhte si i besueshëm fakti se i akuzuari SH.R , kur ishte ndalur vetura nga ulësja e pasagjerit të kishte dalë me pushkë automatike në dorë dhe të kishte shtënë përnjëherë në drejtim të familjes M atëherë gjurmët e hedhjes së gëzhojave do të gjendeshin jashtë rrugës dhe pjesës tokësore, por do të kishin përfunduar në sipërfaqen e livadhit ku ndodhet shtëpia e drurit e familjes M , porse të gjitha gëzhojat kanë qenë të shpërndara në sipërfaqen e asfaltuar të rrugës dhe kjo tregon përputhshmëritë e gjurmëve të gjetura me pozitën në të cilën ka qenë i akuzuari Sh në momentin e të shtënave. Gjithashtu ky fakt vërtetohet edhe mbi bazën e procesverbalit të autopsisë për tani të ndjerin B. dhe mendimit të ekspertëve mjekoligjor për lëndimet e të dëmtuarit L. A , mbi bazën e së cilave ekspertja e balistikës H. H ka dhënë përfundimin se pozita e qitësit (të akuzuarit SH.R) në raport me pozitën e viktimave ka qenë më poshtë ngase për këtë mendimet e ekspertëve mjeko-ligjorë kanë përshtetur në mënyrë të saktë trajektorët e plumbave prej të cilëve njëri ka goditur në pjesën e pasme të shpinës dhe ka dalur në pjesën e parme me trajektore nga poshtë lartë me dallim prej 3 cm dhe dy plagë të dëmtuarit L në mbigjunjët e të dy këmbëve që konsistojnë se si i vetmi vend nga i cili janë zbrazur të shtënat është pjesa e kanalit që ndodhet në mes murit të oborrit të shtëpive të familjes M dhe rrugës së asfaltuar. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me raportin balistik të ekzaminimit të audio incizimeve të marra nga kamera e sigurisë të shtëpisë së K. S, ka vlerësuar vetëm faktin se janë dëgjuar gjithsejtë 12 të shtëna, ndërsa nuk ka mundur të vërtetohet se sa armë janë përdorur në çastet kritike. Megjithatë kjo provë vërteton një fakt shumë të rëndësishëm pasi që në të njëjtën dëgjohej në mënyrë të qartë dhe të dallueshme se fillimisht ka ndodhur një e shtënë-krismë e pastaj, pas 45 sekondash janë dëgjuar të shtënat tjera rrafallë nga e cila me besueshmëri shumë të lartë mund të përfundohet se në fakt i akuzuari F është i pari i cili ka përdorur armën dhe ka shtënë në të akuzuarin R i cili është plagosur në anën e majtë të belit, në të cilat çaste si pasojë e intensiteti të lartë të stresit dhe dhimbjeve ka vepruar në menytë të pakontrolluar për çfarë edhe duhet besuar se momentet kur ka shtënë me armë nuk i

kujtohen, sikur që nuk i është kujtuar as momenti i arritjes së dëshmitarit H. B dhe qëndrimit të tij në afërsi të akuzuarit, por për këtë ka kuptuar vetëm më vonë.

Po ashtu, me qëllim të ndriçimit sa më të drejtë të çështjes propozimi i dhënë nga mbrojtja në shqyrtimin gjyqësor të dt.05.07.2024, fq.7 dhe 8, nga gjykata është refuzuar me arsyetimin se ekspertja e balistikës ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në raportin shtesë pas kryerjes së rikonstruimit të vendit të ngjarjes, veprim ky i cili është reflektuar në vërtetimin jo të plotë të gjendjes së fakteve për arsyen e cekur më afër të dhëna në propozim e që kanë të bëjnë me distancën e gëzhjave nga pushka automatike deri në vendin e gjetjes, përputhshmërinë e pozitës së të akuzuarit Sh dhe vendndodhjen e tij në raport me gjurmët e mbetura të gëzhjave, për të nxjerrë përfundim të drejtë në këtë çështje.

Sipas mbrojtjes, në dëm të akuzuarit SH.R është shkelur ligji penal si pasojë e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit tejet të gabuar të gjendjes së fakteve. Kjo për arsyen se përkundër kundërthënieve diametralisht të kundërta të deklaratave të dëshmitarëve të cilëve gjykata ju ka besuar rreth shpjegimit për pozitën dhe vendin nga ka shtënë i akuzuari Sh , në raport me provat materiale siç janë skica e vendit të ngjarjes, gjurmët e fiksuara të gëzhjave në sipërfaqen e asfaltuar dhe në mënyrë të qartë të shpjeguara në tabelën e matjeve në vendin e ngjarjes.

Po ashtu, sipas mbrojtjes nuk mund të anashkalohej rëndësia e provës së ekzaminimit të krismave të nxjerra nga kamera e sigurisë së shtëpisë së K. S se përkundër faktit që nuk ka mundur të vërtetohen llojet e armëve apo armës, në bazë të fuqisë së të shtënave dhe krismave, me rastin e administrimit të saj në shqyrtimin gjyqësor arritëm të dallojmë intervalin kohor në mes të një të shtëne dhe të shtënave tjera rafalë, fakt ky i cili konsiston me deklaratën e të akuzuarit Sh dhe provat tjera materiale se është i akuzuari F ai që ka shtënë herën e parë me pushkën e gjuetisë, ndërsa freth 5-6 sekonda më vonë ka shtënë i akuzuari Sh . Andaj mbrojtja pretendon se në veprimet e të akuzuarit SH.R të ndërmarra në momentin kritik inkorporohen elementet e Institutit të Mbrojtjes të Nevojshme.

Lidhur me vendimin mbi dënimin mbrojtja pretendon se dënimi i shqiptuar të akuzuarit SH.R është tejet i kundërligjshëm në raport me veprën penale të Vrasjes së Rëndë për çfarë duke patur parasysh se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale me dispozitave të procedurës penale, se gjendja e fakteve është vërtetuar në mënyrë tejet të gabuar dhe jo të plotë për çfarë ka

pasur për pasojë edhe shkeljen e ligjit penal në dëm të akuzuarit. Ndërsa lidhur me veprën penale të përshkruar në dispozitivin II dënimi i shqiptuar për këtë vepër është tejet i ashpër, ngase në prezencën e rrethanave se i akuzuari Sh që nga fillimi ka pranuar fajësinë për kryerjen e kësaj vepre, se i njëjti kurrë në jetën e tij nuk ka qenë i gjykuar, është i martuar, baba i 5 fëmijëve, 4 prej të cilëve janë të moshës së mitur, se pjesën kryesore të jetës së tij e ka kaluar në mërgim duke u përpjekur që të kontribuoi për familjen e tij në mënyrë që të arrijë që fëmijëve të vet të iu sigurojë një të ardhme më të mirë.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të të akuzuarit R. R , Av. Shyqyri Syla

Lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale mbrojtja konsideron se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës. Me të gjitha provat e administrara në shqyrtim gjyqësor dëshmohet se R. R dhe SH.R ishin nisur në dyqanin e fshatit “te Asllani” për tu furnizuar me pije pasi që e martonin motrën dhe posa kanë arritur tek shtëpia e të dëmtuarit- viktimës B. M , automjeti i tyre është ndaluar nga turma dhe me këtë rast i akuzuari R. R nga ana e A. M t është nxjerrë me dhunë nga automjeti dhe asesi nuk qëndron ajo çfarë thuhet në dispozitivin e aktgjykimit. Kjo më së miri dëshmohet nga deklarata e të akuzuarit SH.R dhe R. R ku dëshmojnë se janë ndaluar me dhunë nga turma duke kaluar për në dyqanin e fshatit prej nga R. R kishte marr automatën nga bagazhi i automjetit për tu mbrojtur dhe sipas të akuzuarit SH.R , R. R nuk e ka ditur fare si i njëjti ka pasur armën në bagazhin e automjetit. Po ashtu, shkelje tjetër e dispozitave të procedurës penale paraqet edhe fakti se ky aktgjykim bazohet edhe në deklaratën e dëshmitarit A. F, të cilën deklaratë trupi gjykues e ka lexuar pa pëlqimin e palëve në procedurë dhe me këtë nuk na është dhënë mundësia që ta ballafaqojmë këtë dëshmitar me dëshminë e tij, por edhe t’i parashtrijmë pyetje me të cilat do të kishim mundësinë ta ndriçonim më mirë këtë çështje penale. Pra, aktgjykimi bazohet në dëshmi të cilën nuk kemi pasur mundësi ta kundërshtojmë asnjëherë.

Sipas mbrojtjes vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike konsiston në faktin se nga përmbajtja e dokumentit mbi provat e shqyrtuara, gjykata vë në pikëpyetje saktësinë dhe bazueshmërinë e vërtetimit të fakteve të rëndësishme. Konstatimi i gjykatës së shkallës së parë në faqen 48, pasuesi 2 të aktgjykimit, është i supozuar dhe nuk ka mbështetje në asnjë provë të administruar në shqyrtim gjyqësor sepse i akuzuari R në asnjë rast dhe në asnjë rrethanë nuk e ka parë armën dhe nuk e ka ditur se ka armë në bagazhin e veturës, Sh u ka qenë pa armë dhe janë nisur në drejtim të dyqanit të fshatit për tu furnizuar me lëngje, e jo për tu kacafytur me familjen M . Kjo

dëshmohet edhe nga dëshmia e dëshmitarëve F. R dhe H. B , të cilët në polici dhe në shqyrtim gjyqësor kanë deklaruar se nuk i kanë parë armë në dorë asnjërit prej të akuzuarve dhe sipas këtyre dëshmime armë nuk kanë parë as në brendinë e veturës. Po ashtu i akuzuari R edhe pse ka qenë i njoftuar nga djali i tij se në të njëjtën ditë nga rruga e ka kthyer me automjet A. M dhe e ka goditur automjetin me një shkop të drurit, mirëpo për këtë i akuzuari e ka kritikuar djalin e tij duke i thënë “mirë ta ka bërë se ti je i vogël me vozitë kerrin” dhe pastaj ka marr automjetin dhe se bashku me SH.R n janë nisur në drejtim të dyqanit të fshatit “te Asllani” me qëllim të furnizimit me lëngje për shkak se kishin aheng dhe e martonin motrën.

Gjithashtu, sipas mbrojtjes dëshmitë e dëshmitarëve L. A , L. Xh , Q M dhe A. F janë të pabesueshme me qene se janë në kundërshtim me provat materiale, janë të sinkronizuara dhe të përgatitura me qëllim që të fshehin realitetin dhe tërë fajin tua hedhin të akuzuarve Sh e R. R pasi që me të dëmtuarin janë familjarë dhe dëshirojnë që t’i ndihmojnë në shmangien e përgjegjësisë se tyre penale. Të njëjtit dëshmitarë po ashtu kanë deklaruar se gjoja R. R ditën kritike ka vozitur me një shpejtësi shumë të madhe mbi 100 km/h e që nuk është e vërtetë me qenë se ne vendin e ngjarjes nuk është gjendur asnjë gjurmë frenimi, se aty kishte policë te shtrirë që e kanë penguar lëvizjen e shpejtë dhe ka qenë e pamundur një shpejtësi e tillë, pra këta dëshmitarë me qëllim devijojnë të vërteten dhe nuk tregojnë se vetura është ndalur nga të dëmtuarit dhe se me këtë rast i akuzuari R. R është nxjerrë me dhunë nga vetura nga ana e A. M vëllait të të ndjerit gjë të cilën e dëshmojnë të gjithë dëshmitaret kur theksojnë se i kanë parë A dhe R duke u kacafytur dhe shtyrë dhe kjo me se miri flet për kredibilitetin e këtyre dëshmitarëve dhe dëshmime të tyre. Gjykata me rastin e vlerësimit të këtyre dëshmime dhe faljes se B nuk e vlerëson sa duhet dhe si duhet rikonstruimin e vendit të ngjarjes bile bile nuk e përmend fare e që nga procesverbali mbi rikonstruimin e vendit te ngjarjes (video-incizimi) qartë shihet se të gjitha gëzhojat e shkrepura me këtë rast janë gjendur prapa veturës të cilën e ka vozitur R. R pra tek bagazhi i veturës e qe kjo vërteton dëshminë e të akuzuarit SH.R se ka gjuajtur pasi që armën e ka nxjerrë nga bagazhi i veturës ndërsa e bën te paqëndrueshme dhe te pabesueshme dëshmitë e dëshmitareve te lartcekur se i akuzuari SH.R ka dalur me armë në dorë nga vetura dhe posa e ka hapur derën e veturës ka filluar në drejtim të viktimave, e që dëshmohet edhe me faktin se në këtë Vend ku pretendojnë dëshmitarët se ka shtënë SH.R nuk është gjetur as edhe një gëzhojë e vetme andaj të gjitha këto i bëjnë të paqëndrueshme dëshmitë e këtyre dëshmitarëve se gjoja SH.R ka dalë me armë nga vetura dhe ka filluar të shtënat menjëherë.

Për më tepër, sipas mbrojtjes i akuzuar R nuk e ka ditur në asnjë rast dhe asnjë moment se vëllai i tij i akuzuari Sh ka pasur automatikun me vete se po ta kishte ditur nuk do ta kishte marr me veten në veturë. Pra mungon dashja e të akuzuarit R që të ndihmojë vëllain e tij në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë meqenëse nuk ka pasur njohuri se posedon armë dhe atë armë nuk e ka parë asnjëherë, e kjo vepër kryhet vetëm me dashje direkte e që në rastin konkret dashja mungon.

Andaj meqenëse ka rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurit R, pasi kjo vepër kryhet vetëm me dashje direkte dhe eventuale, dashja nuk është manifestuar tek i pandehuri R që të ndihmojë vëllain e tij Sh që të privojë nga jeta të dëmtuarin B. M sepse i njëjti nuk ka ditur se vëllai i tij ka armën me vete dhe po të kishte ditur nuk do ta merrte me vete andaj është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarit.

Sipas mbrojtjes si pasojë e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe shkeljes së ligjit penal ka ardhur deri te vendimi mbi sanksion penal dhe shqiptimi i dënimit. Gjykata ka nënvlerësuar rrethanat lehtësuese duke mos i vlerësuar mjaftueshëm edhe këto rrethana faktin se është relativisht i moshuar, pendimin e tij të thellë për ngjarjen që ka ndodhur, i gjendjes së dobët ekonomike dhe është mbajtës i vetëm i familjes ndërsa rrethanat rënduese i ka mbivlerësuar sepse përgjegjësia penale dhe intensiteti i dëmtimit dhe lëndimet e pësuar janë pjesë përbërëse të vetë figurës së veprës penale dhe nuk mund të cilësohen si rrethana rënduese dhe vlerësimi i drejtë i te gjitha rrethanave të mësipërme kumulative (lehtësuese dhe rënduese) arsyetojnë shqiptimin e një dënimi më të butë nga ai i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, sepse edhe me një dënim te tillë, në kuadër të qëllimeve të përgjithshme të ekzekutimit të sanksioneve penale nga neni 5 të KPK-së do të arrihet qëllimi i dënimit të parashikuar me nenin 38 të KPK-së, sepse dënimin me burgim do të ketë efekt negativ pasi që dihet se qëllimi i dënimit është preventiv e jo represiv.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të të akuzuarit F. M , Av. Gani Rexha

Mbrojtësi i të akuzuarit pretendon se me aktgjykimin e ankimuar nuk është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendja faktike. Në këtë çështje penale duke pasur parasysh faktin se i akuzuari SH.R me të shtëna nga pushka automatike e privoj nga jeta të ndjerin B. M, përndryshe axha i të akuzuarit F. M në prezencën e të akuzuarit F dhe para syve të tij duke i shkaktuar plagë vdekjeprurëse dhe gjakosur në trupin e tij. Shtrohet pyetja se i akuzuari F. M a e kryejti veprën

penale të vrasjes në tentativë në gjendje të tronditjes së fortë mendore apo jo?. Mendimin e ekspertit të psikiatrisë Dr. A. B të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 30.04.2024, faqe 3 të arsyetimit të aktgjykimit, të cilin mendim gjykata e aprovon në tërësi dhe në të cilin mendimin e mbështet aktgjykimin e kundërshtuar, e të cilin mendim mbrojtja e kundërshton në tërësi si mjaft kontradiktor me vet mendimin e tij. I akuzuari F. M ditën kritike nuk e kryejti veprën penale të vrasjes në tentativë në gjendje të tronditjes së fortë mendore nga arsyeja se të akuzuarit i kujtohej e gjithë rrjedha e ngjarjes, i kujtohen të gjitha elementet e asaj ngjarje dhe ndodhjet e të gjitha aktereve të ditës kritike, i kujtohet arsyeja e shkuarjes në shtëpi dhe në ato momente e dinte saktë vendndodhjen e qitjes me armë gjuetie dhe prapë kthehet në vendin ku ka ndodhur vepra dhe bën veprimin për të cilin është akuzuar. Pra të gjitha këto fakte i njëjti ua ka shpjeguar ekspertëve gojarisht në të dy rastet e intervistimit duke bërë edhe skicën e saktë të lëvizjes së tij dhe pozitive të të gjithë personave në atë ngjarje. Përveç kësaj thekson se edhe gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të cilin e kanë pasur para vetes shihet fare qartë fakti se të gjitha këto veprime të tij janë bërë me vetëdije dhe i kujtohet e gjithë rrjedha e ngjarjes.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit nuk i sqaron dhe arsyeton dy fakte mjaft të rëndësishme që eksperti A. B i ka cekur gjatë shqyrtimit kryesor. E para se në momentin e kryerjes së veprës penale nga i akuzuari F. M tek i njëjti ka ekzistuar një gjendje e jashtëzakonshme psiqike për shkak të të shtënave të cilat kanë ndodhur ditën kritike dhe për shkak të ngjarjes që e ka parë i akuzuari F. M , po ashtu gjykata e shkallës së parë nuk jep arsyetim të mjaftueshëm në përgjigjen e ekspertit të neuropsikiatrisë i cili në faqen 10 paragrafi i parë të arsyetimit të aktgjykimit ka deklaruar nuk kemi shkallëzim, ka mundur të ketë të luhatur të menduarit dhe po qëse veprimi i tij të kishte ndodhur në atë moment atëherë kishim mundur të flasim për një tronditje të fortë mendore, në rast se do ta kishte pushkën e gjuetisë me vete do të kishim diskutuar më shumë për çështjen e tronditjes mendore".

Sipas mendimit të ekspertit të neuropsikiatrisë Dr. A. B tronditja e forte mendore tek i akuzuari F. M do të ekzistonte në rast se i akuzuari do ta kishte pushkën e gjuetisë me vete dhe do të shtinte në të akuzuarin SH.R në ato qaste kur i akuzuari ka shtënë me pushkë automatike në të ndjerin B. M, porse shkuarja e tij deri në shtëpi, marrja e pushkës së gjuetisë dhe kthimi në vendin e ngjarjes pas një kohe mjaft të shkurtë dhe shtëna në të akuzuarin SH.R e përjashton tronditjen e fortë mendore që do të thotë se tronditja e fortë mendore është evituar nga psikika e të akuzuarit F për një kohë kaq të shkurtër.

Mbrojtja konsideron se tronditja e fortë mendore sipas literaturës shkencore nuk mund të evitohet nga personi brenda një kohe kaq të shkurtë porse e njëjta mund të zgjas edhe me ditë të plota. Prezenca e gjendjes së jashtëzakonshme psiqike tek i akuzuari e vërteton në tërësi tronditjen e fortë mendore, edhe dëshmia e dëshmitarit L. Xh të dhënë në procesverbalin e vazhdimit të shqyrtimit gjyqësor të datës 11.12.2023, faqe 19 në pyetjen e mbrojtësit të të akuzuarit F se kur F e ka parë të ndjerin B. që ka qenë i plagosur a e ka parë A e tij, i njëjti përgjigjet ka bërë shumë, unë kishe luajtë prej mendjes krejt, dhe pas kësaj vrap ka shkuar në shtëpinë e tij për ta marr pushkën e gjuetisë e cila ishte në një distancë 10-15 metra nga vendi i ngjarjes". Këtë dëshmi të këtij dëshmitari eksperti i neuropsikiatrisë A. B fare nuk e merr në shqyrtim e as gjykata nuk e jep as të vetmin arsyetim edhe pse eksperti thirret në shqyrtimin e të tëra shkresave të lëndës të cilat ia ka dorëzuar gjykata.

Për të ekzistuar vepra e kryer në gjendje të rëndë të tronditjes së fortë mendore duhet të plotësohen tri kushte themelore pa ekzistimin e të cilave nuk ekziston as kjo veprë penale. E para, tronditja e rëndë ekziston kur shkaktohet gjendje e jashtëzakonshme psikike, me c' rast kryerësi pa gjykuar në mënyrë kritike në moment vendos ta kryejë veprën. E dyta, që kryerësi të vihet në gjendje të tronditjes së fortë mendore pa fajin e tij për shkak të sulmit, keqtrajtimit, ose fyerjes së rëndë të të akuzuarit SH.R dhe e treta, se vepra të kryhet në gjendje të tronditjes mendore nëse ajo ka ndodhur menjëherë pas sulmit, keqtrajtimit ose fyerjes dhe nën ndikimin e tronditjes mendore. Mbrojtja konsideron se në rastin konkret janë plotësuar të tri kushtet themelore për ekzistimin e kësaj vepre penale.

Lidhur me vendimin mbi dënimin mbrojtja konsideron se dënimi i shqiptuar është tepër i rëndë si pasojë e mos vlerësimit të rrethanave të këtij rasti. Fakti se i akuzuari F. M ditën kritike ka vepruar në gjendje të tronditjes së fortë mendore pa fajin e tij, se tërë ngjarjen e vrasjes së xhaxhait të tij e ka parë me dy sytë e vet, se është i ri dhe baba i dy fëmijëve të mitur, më parë i pagjykuar, ndaj tij nuk zbatohet ndonjë procedurë tjetër penale, sikur këto rrethana lehtësuese të vlerësoheshin sa duhet me siguri se vendimi mbi dënim do të ishte më i favorshmen për të akuzuarin.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson, se pretendimet e mësipërme ankimore sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk qëndrojnë, e gjithashtu nuk ka shkelje tjera të dispozitave të procedurës nga neni 384 të KPPRK-së, për të cilat shkelje kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e të cilat do të kushtëzonin anulimin e këtij aktgjykimi.

Dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni të plotë me arsyetimin, ndërsa në arsyetim janë dhënë arsye të qarta dhe të plota lidhur me faktet vendimtare të cilat vërtetojnë se në veprimet e të akuzuarit SH.R janë formësuar elementet e veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 173 par.1, pika 1.5 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, në veprimet e të akuzuarit R. R janë formësuar elementet e veprës penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 pika 1.5 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, ndërsa në veprimet e të akuzuarit F. M janë formësuar elementet e veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Kjo gjykatë vlerëson se Gjykata e shkallës së parë ka analizuar të gjitha provat e procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me këto prova ka paraqitur konkludimet e saj, e të cilat si të drejta, objektive dhe të ligjshme, i vlerëson edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat ligjore, duke dhënë arsye të qarta dhe konkrete për vendin, kohën dhe mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e veprave penale nga ana e të akuzuarve.

Sa i përket pretendimeve ankimore të prokurorit të shtetit përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për të akuzuarit R. R , Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se këto pretendime nuk qëndrojnë dhe se Gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se nga provat e administruara, konkretisht dëgjimit të dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor, është vërtetuar se i akuzuari R. R e ka dërguar vëllain e tij me automjetin e tij në vendin e ngjarjes, përkatësisht para shtëpisë së familjes M , ashtu që ka ekzistuar dashja e tij për ta ndihmuar të akuzuarin Sh në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë, andaj në veprimet e tij janë formësuar elementet e veprës penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 pika 1.5 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, ndërsa nuk është vërtetuar se i akuzuari R të ketë kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, pasi që të gjithë dëshmitarët e dëgjuar

në këtë çështje penale kanë deklaruar se të pandehurit R atë ditë në vendin e ngjarjes nuk i kanë parë armë, e përveç kësaj me asnjë provë të vetme materiale nuk është arritur të vërtetohet se ky i pandehur të ketë poseduar armë. E për armën për të cilën janë akuzuar që të dy të pandehurit R dhe Sh , i pandehuri Sh e ka pranuar fajësinë në shqyrtim gjyqësor dhe pranimi i fajësisë është miratuar nga gjykata e shkallës së parë.

Sa i përket pretendimeve ankimore të mbrojtësit të të akuzuarit SH.R , Av. Mahmut Halimi përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se Gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari SH.R e ka kryer veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 173 par.1, pika 1.5 të KPRK-së, për të cilën është shpallur fajtor.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari SH.R në mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, nga fakti se më datë me datë.23.07.2022 rreth orës 18:45 minuta në fshatin B, Komuna S, me dashje, ka privuar nga jeta viktimën B. M , si dhe ka plagosur të dëmtuarin L. A , ashtu që pas një fjalosje që ka ndodhur më herët ndërmjet djalit të mitur të të pandehurit R. R , F. R , i cili rreth 5 minuta para ngjarjes kishte drejtuar automjetin e tipit Audi A6 me shpejtësi të lartë afër shtëpisë së viktimës B. M dhe në atë moment kishte ndërhyrë vëllai i viktimës, A. M , duke e goditur automjetin e të pandehurit R. R me një shkop të drurit dhe pas kësaj i mituri kthehet ne shtëpi, i kishte njoftuar të pandehurit lidhur me rastin, ashtu që pastaj i pandehuri SH.R ka marrë pushkën automatike AK-47 me nr. serik..., dhe i pandehuri R. R me veturën e njëjtë të tipit Audi A6 ngjyrë hiri e ka derguar deri te shtëpia e viktimës dhe posa është afruar, i pandehuri R. R e ka ndale automjetin, ndërsa i pandehuri SH.R ka dalë nga vetura ne atë mënyrë që i pandehuri Sh me dashje që t'i privojë nga jeta personat e familjes M që kanë qenë në vendin e ngjarjes, ka filluar të shtije më pushkë automatike AK-47 në drejtim të tyre si pasojë e të shtënave me armë zjarri ka privuar nga jeta viktimën B. M , vdekja e të cilit ka ardhur si pasojë e gjakderdhjes së jashtme dhe të brendshme e shkaktuar nga shqyerja e lobit të sipërm dhe të poshtëm të mushkërisë së majtë, si dhe ka plagosur L. A n të cilit si pasojë e goditjes nga predha e armës i janë shkaktuar, plage depertuese me arme zjarri ne regjionin e te dy kofsheve, te cilat jane te shkaktuara nga veprimi dinamik i predhave te hedhura nga arma e zjarrit dhe si te tilla bejne pjese ne demtime te lehta trupore me pasoja te perkohshme per shendetin.

Deri të kjo gjendje faktike, Gjykata e shkallës së parë kishte ardhur pas administrimit të provave personale siç janë: dëshmia e të dëmtuarit-dëshmitarit L. A , dhe dëshmitarve L. Xh , H. B , Q M , F. R , është lexuar deklarimi i dëshmitarit A. F i dhënë në policinë e Kosovës, ka degjuar ekspertet mjeko ligjore Dr. V. H dhe Dr. D. H dhe ekspertet e Agjencionit të Forenzikës së Kosovës; S.D, B. H dhe M.T, ekspertin e balistikës H.H, si dhe ekspertin e Psikiatrisë Forenzike Dr. A. B , ka bërë rikonstruimin e vendit të ngjarjes në fshatin B, komuna e S. Ndërsa ka administruar këto prova materiale: Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Njësia e Forenzikës të dt.23.07.2022, Lista e dëshmimeve nga Njësia e Forenzikës dt.25.07.2022, Skica e vendit të ngjarjes dt.23.07.2022, Ekzaminimi i veturës Golf VI dhe fotoalbumi me 20 fotografi të dt.23-24.07.2022, Raporti i autopsisë nga Njësia e Forenzikës te dt.24.07.2022 dhe fotoalbumi me 48 fotografi, Tabela e matjeve në vendin e ngjarjes te dt.23.07.2022, Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve te dt.23.07.2022, Raporti i oficerit Nexhat Imeraj i dt.23.07.2022, Raport i policit B.S i dt.24.07.2022, Raporti informues i hetuesit i dt.24.07.2022, Raporti informues hetimor i dt 24.07.2022, Raporti fillestar i incidentit dt.23.07.2022, Raporti i policit hetuesit i dt.22.08.2022, Raporti i policit hetues i dt.29.08.2022, Raporti i policit hetues i dt.06.02.2023, Raporti i policit hetues i dt.24.02.2023, Fletë lëshimi nga QKUK Klinika e Ortopedisë dhe Traumatologjisë Lokomotore për L. A i dt.26.07.2022, Fletë lëshimi nga QKUK, Reparti Klinik i Kirurgjisë Abdominale HB për SH.R n i dt.27.07.2022, Akt-ekspertimi mjeko-ligjor nga Instituti i Mjekësisë Ligjore Dr.D.H për SH.R dhe L. A , me nr. Ref. ... i dt...., Akt ekspertimi mjeko ligjor nga Instituti i Mjekësisë Ligjore (Plotësim), Dr.D.H për SH.R dhe L. A , i dt. 19.04.2024, Akt ekspertimi mjeko-ligjor i dt.21.06.2024 nga Instituti i Mjekësisë Ligjore (Plotësim) pas rikonstruimit të vendit të ngjarjes, Raporti i autopsisë për B. M nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, Dr.V.H i dt.02.11.2022, Raport i ekspertimit nga AKF-ja nga sektori i balistikës me nr.referues AKF AKF-... të datës 26.06.2023, Raport i AKF-së i dt.21.06.2024 për plotësimin e raport të ekspertizës balistike të dt.26.06.2023 pas rikonstruimit të vendit të ngjarjes, Raporti i ekspertimit na Agjencia e Kosovës për Forenzikë me nr.AKF/... i datës 31.01.2023, Raport i ekspertimit nga AKF-ja nga sektori i daktiloskopisë dhe traseologjisë me nr.referues AKF-... të datës 21.06.2023, Raport i ekspertimit nga AKF-ja nga sektori i serologjisë me nr.referues AKF-... të datës 23.08.2023, Raport i ekspertimit nga AKF me nr.referues AKF-... të datës 01.11.2022 dhe CD-te ku dëgjohen të shtënat ditën kritike dhe Raport për gjendjen e shëndetit mendor të F. M t nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike të datës 15.04.2024.

Andaj pretendimet e mbrojtësit së të akuzuarit se nga Gjykata e shkallës së parë gjendja faktike në këtë çështje është vërtetuar në mënyrë tejet të gabuar dhe jo të plotë, sepse pa kurrfarë

mbështetje dhe në kundërshtim me të gjitha provat materiale iu është falur B dëshmitarëve L. Xh , Q M , të dëmtuarit L. A dhe dëshmisë së lexuar të dëshmitarit A. F , janë pretendime të pabazuara, pasi që nga provat personale dhe materiale të administruara në shqyrtim gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari Sh e ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë me datë 23.07.2022, ashtu që pasi që vëllai i tij R e ka dërguar me automjetin e tij nga shtëpia e tyre deri në vendin e ngjarjes dhe i akuzuari Sh ka zbritur nga automjeti, ka shtënë disa herë me armë zjarri në drejtim të të ndjerit B. M , ashtu që të njëjtin e ka privuar nga jeta dhe me dashje ka vënë në rrezik jetën e personave tjerë që ishin prezent te dyert e oborrit të shtëpisë së familjes M , ku gjithashtu ka plagosur në të dy këmbët të dëmtuarin L. A i cili ishte punëtor duke kryer punë mjeshtërie te familja M . Këtë gjendje faktike gjykata e shkallës së parë drejt e ka vërtetuar nga deklarimi i dëshmitarëve L. Xh , Q M dhe L. A , të cilëve ua fali B n e plotë pasi qe te njëjtit ne deklarimet e tyre nuk kishin kundërthënie mes vete, përkundrazi deklarimet e tyre plotësonin njëra tjetrën dhe nga këto deklarime pa kurrfarë mëdyshje është vërtetuar se atë mbrëmje fillimisht A. M nga rruga e kishte kthyer me automjetin e tij femiun e mitur të të pandehurit R. R , e pastaj pas nje kohë te shkurtër ne vendin e ngjarjes është kthyer i njëjti automjet te cilin tani ishte duke e vozitur i pandehuri R. R dhe si pasagjer ishte i pandehuri SH.R dhe pasi qe është ndal ky automjeti i pandehuri SH. R ka zbritur nga automjeti me armë në dorë dhe përnjëherë me armën e tij ka filluar qe te shtije në drejtim të atyre që ishin në rrugë para dyerve të oborrit të familjes M , me c' rast me një predhë e ka goditur tani viktimën B. M i cili ka mbetur i shtrirë në rrugë e po ashtu ka goditur në të dy këmbët edhe të dëmtuarin L. A .

Përveç dëshmimeve të dëshmitarëve L. Xh , Q M , të dëmtuarit L. A dhe dëshmisë së lexuar të dëshmitarit A. F , gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes ne raport me te akuzuarin SH.R , i vlerësoi dhe u bazua edhe ne provat materiale si në: Raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Njësia e Forenzikës të dt.23.07.2022, Listën e dëshmimeve, Skicën e vendit të ngjarjes dt.23.07.2022, dhe Tabelën e matjeve në vendin e ngjarjes te dt.23.07.2022, nga te cilat u vërtetuan dëshmitë e gjetura ne vendin e ngjarjes, pastaj pozicionimi i tyre ne vendin e ngjarjes dhe distanca e tyre nga pikat fikse. Gjithashtu nga raporti i autopsisë u vërtetua shkaku i vdekjes se te ndjerit, pastaj nga ekspertiza e mjekësisë ligjore u vërtetuan lloji dhe natyra e lëndimeve te pësuar nga i dëmtuari L. A , nga ekspertiza balistike u vërtetua se arma automatike “...” model Type-... e kalibrit ... mm, me numër serik është përdorur atë dite ne raste pasi qe në vendin e ngjarjes janë evidentuar dëshmitë balistike, përkatësisht shtatë (7) gëzhoja të kalibrit ... mm të evidentuar me D1, D2, D3, D4, D5, D6, dhe D7, dhe të njëjtat janë te shkrepura nga e njëjta pushke automatike, pastaj është përcaktuar pozita e personit i cili ka shtënë me arme ne raport

me viktimat qe ne këtë rast ka qene përballë viktimave dhe trajektorja e lëvizjes së plumbit në trupin e viktimës.

Sa i përket pretendimeve ankimore të mbrojtësit të të akuzuarit R R, Av. Shyqyri Sylja, përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se Gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari R. R e ka kryer veprën penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 173 par.1, pika 1.5 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, për të cilën është shpallur fajtor. Gjykata e shkallës së parë këtë gjendje faktike e vërtetoi drejt në bazë të dëshmimeve të dëshmitarëve L. A , L. Xh dhe Q M , te dhëna në shqyrtimet gjyqësore, si dhe deklaramit të dëshmitarit A. F të dhënë në policinë e Kosovës, e që për këtë dëshmitar gjykata e shkallës së parë ka bërë përpjekje të arsyeshme për të siguruar pjesëmarrjen në seancë po ashtu, deklarimi i tij nuk është përdorur si provë e vetme apo vendimtare për të vërtetuar gjendjen faktike por, këto deklarime të dëshmitarëve gjenin mbështetje dhe plotësonin njëra tjetrën dhe nga këto prova vërtetoi faktin se atë ditë automjetin deri në vendin e ngjarjes e ka vozitur i pandehuri R. R , pastaj faktin se i njëjti ne vendin e ngjarjes nuk ka ndërmarr asnjë veprim dhe pasi qe ka përfunduar rasti është larguar ne drejtim te shtëpisë se tij.

Pretendimi i mbrojtjes se i akuzuari R nuk e ka ditur në asnjë rast dhe asnjë moment se vëllai i tij i akuzuari Shuki ka pasur automatikun me vete se po ta kishte ditur nuk do ta kishte marr me veten në veturë, është pretendim i pabazuar ngase nga të gjitha provat e administruara nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar se në ditën kritike ka ekzistuar dashja e të akuzuarit që të ndihmojë vëllain e tij, të akuzuarin Sh për të kryer veprën penale të vrasjes së rëndë, pasi që i njëjti paraprakisht ka qenë i njoftuar nga djali i tij se të njëjtin nga rruga e ka kthyer me automjet A. M dhe e ka goditur automjetin me një shkop të drurit, pra duke qenë në dijeni për problemin e shkaktuar në mes të djalit të tij të mitur dhe vëllait të viktimës, mirëpo përkundër kësaj e ka dërguar të akuzuarin Sh me automjetin e tij në vendin e kryerjes së veprës penale, para shtëpisë së familjes M dhe sipas dëshmimeve të dëshmitarëve L. A , L. Xh dhe Q M , të dhëna në shqyrtimet gjyqësore, si dhe deklaratës së dëshmitarit A. F , të cilave gjykata ua ka falur B i akuzuari Sh ka zbritur nga vetura me armë në dorë dhe me të cilën pastaj edhe e ka goditur viktimën dhe të dëmtuarin L. A , andaj mbi bazën e këtyre provave vërtetohet se i akuzuar R ka qenë në dijeni se i akuzuari Sh kishte armën me vete dhe ka ekzistuar dashja e të akuzuarit R për të ndihmuar vëllain e tij në kryerjen e veprës vrasje e rëndë.

Lidhur me pretendimet ankimore të mbrojtësit të të akuzuarit F. M , Av. Gani Rexha përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit konsideron se këto pretendime nuk qëndrojnë, ngase Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ia ka falur B n Raportit të ekspertizës së Psikiatrisë Forenzike, ku nga ky raport dhe nga dëgjimi i ekspertit të psikiatrisë forenzike në shqyrtim gjyqësor ka rezultuar se tek i pandehuri F ditën kritike nuk ka pasur tronditje të fortë mendore. Pra nga raporti i Ekspertizës së Psikiatrisë Forenzike për të pandehurin F. M rezulton se gjatë ekzaminimit psikiatrik tek i njëjti nuk është konstatuar çrregullim mendor i përkohshëm apo i përhershëm, ndonjë sëmundje mendore e përkohshme apo përhershme, si dhe nuk janë konstatuar ngecje ne zhvillim mendor. Bazuar në të dhënat e fituara gjatë intervistimit të të njëjtit nuk janë konstatuar elementet e tronditjes mendore e cila do te ndikonte ne humbjen e kontrollit të veprimeve të tija dhe në të gjykuarit e pasojave të veprimeve të tija. Llogaritshmëria në kohën e kryerjes së veprës penale për të cilën ai akuzohet ditën kritike ka qenë e ruajtur.

Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor ka vërtetuar se tek i akuzuari F. M ditën kritike ekzistonte dashja që të pandehurin SH.R te privojë nga jeta, sepse i njëjti ka ndërmarr veprime te caktuara me qëllim që te njëjtin te privoje nga jeta, pasi që nga një distance e afërt ka shtënë ne drejtim te tij me armen e tij te zjarrit, përkatësisht me pushkën e gjuetisë duke e qëlluar ne regjionin e majtë anësor te pjesës se poshtme te shpinës dhe barkut, pra ne pjese vitale te trupit, i vetëdijshëm se ato mund te ishin fatale për jetën, që paraqesin plagë me gjak mbledhje nën lëkurore në indet e buta përreth, te cilat janë te shkaktuara nga veprimi dinamik i predhës se hedhur nga arma e zjarrit dhe si te tilla bëjnë pjese ne dëmtime te lehta trupore me pasoja te përkohshme për shëndetin. Pra, nga rrethanat faktike nxjerrët dashja e të akuzuarit, që në rastin konkret ka qenë privimi nga jeta i të pandehurit SH.R dhe si rrjedhoje u vërtetua përtej çdo dyshimi se i akuzuari F. M ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 te KPRK-së, për çka gjykata te njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptojë dënimin si ne dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Andaj, Gjykata e Apelit e Kosovës duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë më lart, vlerëson se Gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në këtë çështje penale nuk ka mbetur pa u vërtetuar asnjë fakt vendimtar.

Kolegji penal i kësaj gjykate i vlerëson si të pabazuara pretendimet ankimore të prokurorit të shtetit lidhur me shkeljen e ligjit penal, meqë Gjykata e shkallës së parë të pandehurin R. R e ka liruar nga akuza për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të

paautorizuar të armëve ngase me asnjë provë të vetme materiale nuk është arritur të vërtetohet se ky i pandehur të ketë poseduar armë ditën kritike, andaj me të drejtë edhe është liruar nga akuza. Gjithashtu kolegji i vlerëson të pabazuara edhe pretendimet e mbrojtësve të të pandehurve lidhur me shkeljen e ligjit penal, pasi nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat që parashihen me dispozitat e KPPRK-së të cilat konsiderohen shkelje e ligjit penal, në veprimet e të akuzuarve formësohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprave penale për të cilat të njëjtit janë shpallur fajtor, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale apo ndjekjen penale të të akuzuarve.

Sa i përket pretendimeve ankimore të Prokurorit të shtetit dhe mbrojtësve të akuzuarve lidhur me vendimin mbi dënimin, kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marr parasysh dhe ka vlerësuar drejt të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Për të akuzuarin SH.R , si rrethanë lehtësuese gjykata gjeti faktin se i njëjti është familjar, përkatësisht baba i pesë fëmijëve, si dhe faktin se i njëjti është i pa dënuar më parë me aktgjykim të formës së prerë, ndërkaq rrethanë rënduese Gjykata gjeti dashjen direkte të pandehurit dhe shkallën e lartë të dashjes së shprehur, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial në këtë vepër penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale, si rrethanë tjetër rënduese ka gjetur intensitetin e dëmtimit përkatësisht vlerës se mbrojtur qe ne rastin konkret ishte jeta e njeriut, pasi qe i njëjti ka privuar nga jeta viktimën.

Për të akuzuarin R. R , si rrethanë lehtësuese gjeti faktin se i njëjti është familjar, përkatësisht baba i pesë fëmijëve, si dhe faktin se i njëjti është i padënuar më parë me aktgjykim të formës së prerë, ndërkaq rrethanë rënduese Gjykata për këte të pandehur ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale, që gjykata ka vërtetuar se i pandehuri ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këtë vepër penale, i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e tij, si rrethanë tjetër rënduese ka gjetur intensitetin e dëmtimit përkatësisht vlerës së mbrojtur që në rastin konkret ishte jeta e njeriut.

Për të akuzuarin F. M , si rrethanë lehtësuese gjeti faktin se i njëjti është familjar, moshën e tij relativisht të re në kohën e kryerjes së veprës penale, si dhe faktin se i njëjti është i pa dënuar më parë me aktgjykim të formës së prerë, ndërkaq rrethanë rënduese Gjykata gjeti dashjen direkte të të pandehurit dhe shkallën e lartë të dashjes së shprehur, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial në këtë vepër penale, mënyrën e kryerjes se veprës penale, si rrethanë tjetër rënduese ka gjetur intensitetin e dëmtimit përkatësisht vlerës se mbrojtur qe ne rastin konkret me veprimet e tij i jane shkaktuar lëndime trupore SH.R. Për të akuzuarin F. M , gjykata

vendosi që të aplikojë dispozitat e zbutjes se dënimit dhe të njëjtit i shqiptojë dënimin me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit nën minimumin e paraparë ligjor, pasi që kryerja e veprës penale nga i akuzuari ka mbetur në tentativë dhe ligji e parasheh mundësinë e zbutjes se dënimit.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se Gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Ndërsa, pretendimin e prokurorit dhe mbrojtësve se dënimi është jo i drejtë, kjo Gjykatë e vlerëson si të pabazuar pasi që të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese kanë qenë objekt vlerësimi nga Gjykata e shkallës së parë dhe pikërisht si rezultat i këtyre rrethanave edhe u është shqiptuar dënimi përkatës, andaj të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të Kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga Gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale të kryera dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve, intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se me të do të parandalohen të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA

PAKR.nr.666/2024

Datë: 12.12.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale

Anëtarët e kolegjit

Kryetar i kolegjit

Jeta Asllani

Kadrije Goga Lubishtani

Hashim Çollaku

Valbona M Selimaj